

Nr. Ref ONM:	AL10/19/CA-036
Kodi i projektit ONM:	CE.0377
Kodi i Aprovimit ligjor nga LEG:	ALB/LCOO/MB0069/2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN, QEVERIA E SHQIPËRISË

DHE

ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE PËR MIGRACIONIN (ONM)

“PËR KONSULTIM NË ÇËSHTJET ME INTERES TË PËRBASHKËT”

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Ministri i Shtetit për Diasporën ("**MSHD**") i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin ("**ONM**") në Shqipëri, pjesë e sistemit të Kombeve të Bashkuara (në vijim referuar individualisht si "**Palë**" dhe kolektivisht si "**Palët**"),

DUKE PASUR PARASYSH se misioni i MSHD me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, Qendrën e Botimeve të Diasporës dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është të promovojë dhe forcojë bashkëpunimin e përgjithshëm ndërmjet komuniteteve shqiptare që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë dhe vendeve pritëse, në çdo aspekt, si dhe duke marrë parasysh autorizimin që legjislacioni shqiptar në fuqi i jep MSHD-së për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe ose shumëpalëshe, në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare,

DUKE PASUR PARASYSH që ONM, e vendosur ndaj parimit që migracioni i rregullt dhe human është në të mirë të migrantëve dhe të shoqërisë, vepron që: të ndihmojë në përmbushjen e sfidave operacionale të migracionit, të nxisë të kuptuarit më të mirë të çështjeve të migracionit, të inkurajojë zhvillimin social dhe ekonomik nëpërmjet migracionit dhe të mbështesë respektimin efektiv të të drejtave të njeriut dhe mirëqenies së migrantëve,

TE NDËRGJEGJSHËM për nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet Palëve në çështje me interes të përbashkët, dhe me dëshirën që të forcojnë më tej këtë bashkëpunim,

KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:

NENI 1

PARIMET E PËRGJITHSHME TË BASHKËPUNIMIT

1. Brenda mandateve të tyre përkatëse dhe në varësi të burimeve në dispozicion, Palët, në bashkëpunim të ngushtë do të kenë konsultime për të gjitha çështjet me interes të përbashkët. Për këtë qëllim, Palët do të shqyrtojnë kuadrin e duhur për këto konsultime kurdo që të jetë e nevojshme.
2. Palët bien dakord që aktivitetet në lidhje me zbatimin e Programit "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë" do të koordinohen, në masën e mundshme, në një përpjekje për të arritur bashkëpunimin dhe kur interesat e përbashkëta diktojnë, njëra Palë mund të kërkojë bashkëpunimin e Palës tjetër.
3. Secila Palë do të përpiqet, sa më shumë që të jetë e mundur dhe në përputhje me instrumentet përbërëse dhe vendimet e organeve kompetente, t'i përgjigjet në mënyrë të favorshme kërkesave të tilla për bashkëpunim, në përputhje me procedurat që bihet dakord për t'u ndjekur reciprokisht.

NENI 2

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE DOKUMENTACIONIT

1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacionin dhe dokumentacionin e disponueshëm publikisht në shkallën më të gjerë të mundshme për çështje me interes të përbashkët.

2. Kur është e përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat e domosdoshme, informacionet dhe dokumentacioni në lidhje me projekte ose programe specifike, mund të shkëmbehen ndërmjet Palëve me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira dhe koordinimit efektiv midis dy Palëve.

NENI 3

VEPRIME TE PËRBASHKËTA

1. Palët, me marrëveshje të posaçme, mund të vendosin të veprojnë bashkërisht në zbatimin e projekteve me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës, Qendrën e Botimeve të Diasporës dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët që janë me interes të përbashkët. Marrëveshje të veçanta do të përcaktojnë modalitetet për pjesëmarrjen e secilës Palë në projekte të tilla dhe do të përcaktojnë shpenzimet e pagueshme nga secili prej tyre.
2. Palët, kurdo që e konsiderojnë të nevojshme, mund të krijojnë komisione, komitete ose organe të tjera teknike ose këshilluese, sipas kushteve që do të bien dakord reciprokisht në secilin rast, për t'i këshilluar ata për çështje me interes të përbashkët.

NENI 4

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Pa paragjykuar bashkëpunimin në fusha të tjera, brenda mandateve të tyre përkatëse dhe në varësi të disponueshmërisë së burimeve, Palët bien dakord të shqyrtojnë fushat e bashkëpunimit në lidhje me Programin "Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë", i zbatuar nga ONM nga 17 Tetor 2017 deri më 31 Gusht 2021. Në veçanti, duke iu nënshtruar kushteve të mësipërme, Palët bien dakord të marrin në konsideratë fushat e mëposhtme të bashkëpunimit të ndërsjellë:

- 1 – *Angazhimi i diasporës për zhvillim në përputhje me politikat e përgjithshme*
- 2 – *Angazhimi i diasporës për zhvillim territorial dhe forcim institucional nëpërmjet transferimit të aftësive dhe dijeve*
- 3 – *Angazhimi i diasporës në zhvillimin e vendit nëpërmjet investimeve*

NENI 5

BASHKËPUNIMI NDËRMJET DY PALËVE

Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Drejtuesja e Zyrës (DZ) së ONM në Shqipëri do të marrin masat e duhura për të siguruar bashkëpunimin dhe ndërlidhjen efektive ndërmjet Palëve. Kjo përfshin bashkëpunimin e ngushtë në këtë fushë, veçanërisht në vende ku përfaqësohen të dyja palët.

NENI 6

ZBATIMI I MARRËVESHJES

Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Drejtuesja e Zyrës (DZ) së ONM në Shqipëri do të konsultohen rregullisht me njëri-tjetrin, për çështjet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje.

NENI 7
MARRËVESHJE SHITESË

Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Drejtuesja e Zyrës (DZ) së ONM në Shqipëri mund të aplikojë marrëveshje shtesë të veçanta me qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin, në bazë të dëshirës së palëve.

NENI 8
KONFIDENCIALITETI

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, duhet të trajtohet si rreptësisht konfidencial. Asnjë informacion personal nuk do t'i komunikohet ndonjë palë të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të personit në fjalë.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave të ONM në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Njëra Palë nuk do të publikojë asnjë dokument të lidhur me Programin pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.
3. Pala nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe / ose të Donatorit të Programit pa marrëveshje paraprake me Palën dhe / ose Donatorin përkatës.
4. Detyrimet e parashikuara në këtë nen mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 9
PRONËSIA INTELEKTUALE

Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejta të tjera pronësore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në patentat, të drejtat e autorit, markat tregtare dhe pronësia e të dhënave që rezultojnë nga aktivitetet ose projektet sipas kësaj Marrëveshjeje do t'i njihen ONM, duke përfshirë pa kufizime të drejtat e përdorimit, riprodhimit, përshtatjes, publikimit dhe shpërndarjes së plotë ose të pjeshme të tyre.

NENI 10
STATUSI I ONM

Asgjë në këtë Marrëveshje apo në lidhje me të nuk do të konsiderohet si heqje dorë, e shprehur ose e nënkuptuar, nga cilido privilegj dhe imunitet i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin si një organizatë ndërqeveritare.

NENI 11
ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo kërkesë që rrjedh nga, ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkelja, ndërprerja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit ndërmjet Palëve.

2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 3 (tre) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila Palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet me pajtim nga një pajtues në përputhje me Rregullat e Pajtimit UNCITRAL të vitit 1980. Neni 16 i Rregullave të Pajtimit UNCITRAL nuk zbatohet.
3. Në rast se një pajtim i tillë është i pasuksesshëm, secila Palë mund të paraqesë ankesë, kundërshtim apo kërkesë në arbitrazh jo më vonë se 3 (tre) muaj pas datës së përfundimit të procedurave të pajtimit sipas Nenit 15 të Rregullave të Pajtimit UNCITRAL. Arbitrazhi do të kryhet në përputhje me rregullat e arbitrazhit 2010 UNCITRAL të miratuar në vitin 2013. Numri i arbitrave do të jetë një dhe gjuha e procedurave të arbitrazhit do të jetë anglisht, përveç nëse Palët me marrëveshje bien dakord ndryshe. Gjyqi i arbitrazhit nuk ka asnjë autorizim për të dhënë dëmshpërblime ndëshkuese. Përcaktimi i arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm.
4. Marrëveshja aktuale, si dhe marrëveshja e mësipërme e arbitrazhit, do të rregullohen nga kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe plotësohen nga parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar të së drejtës për çështjet që nuk mbulohen nga marrëveshja, duke përjashtuar çdo sistem legjislativ kombëtar që do ta shtynte Marrëveshjen drejt ligjeve të një juridiksioni të caktuar. Parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar do të përfshijnë edhe parimet e UNIDROIT të Kontratave Ndërkombëtare Tregtare. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve do të ndiqet në mënyrë konfidenciale nga të dy Palët. Ky nen mbijeton me skadimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 12

HYRJA NË FUQI, AMENDIMET DHE KOHËZGJATJA

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me efekt prapaveprues nga 8 janari 2018 pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve. Me hyrjen në fuqi të saj, Palët do t'ia bëjnë të ditur personelit në terren dhe atij të zyrës Qendrore.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi i propozuar duhet të bëhet me shkrim nga njëra Palë dhe do të hyjë në fuqi pas pranimit të saj me shkrim nga Pala tjetër.
3. Secila nga palët mund ta përfundojë këtë Marrëveshje duke i dhënë njoftim me shkrim 6 (gjashtë) muaj përpara Palës tjetër.
4. Kjo marrëveshje bëhet në dy kopje në gjuhët anglisht dhe shqip. Ministri i Shtetit për Diasporën merr një kopje në anglisht dhe një në gjuhën shqipe, ONM merr një në anglisht dhe një në gjuhën shqipe. Të gjitha kopjet janë identike. Në rast të kundërshtive, teksti i anglishtes do të përdoret për të zgjidhur çështjen.

NË DËSHMI TË SA ME SIPËR, përfaqësuesit e nënshkruar të Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin e firmosin këtë Marrëveshje.

*Për dhe në emër të
Ministrit të Shtetit për Diasporën*

Firma

*Pandeli MAJKO
Ministri i Shtetit për Diasporën*

*Për dhe në emër të
Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin*

Firma

*Alma JANI
Drejtuese e Zyrës*

Në prani të:
Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës Sonila Hysa
Drejtorit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës Majlinda Vogli
Drejtorit të Qendrës së Botimeve të Diasporës Mimoza Hysi
Drejtorit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët Diana Kastrati.